

# Vettingu shkarkon Nikollin, gjyqtarin që lehtësoi dënimin e Dajtit, vrasës i katër policëve

10 Gusht 2020 LAJME

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shkarkuar gjyqtarin Aleks Nikolli. Komisioni vërejti se kishte pamundësi financiare për ndërtimin e një shtëpie trekatëshe në fshatin Ishull Shëngjin të Lezhës, ku gjyqtari Nikolli rezulton si pronar i katit të dytë me sipërfaqe 147.8 m<sup>2</sup>. Komisioni ngriti gjithashtu dyshime për një kontratë huapërdorjeje reciproke mes gjyqtarit Aleks Nikolli dhe vëllait të tij L.Nikolli që jeton në Mbretërinë e Bashkuar prej më shumë se dy dekadash, lidhur me një apartament të këtij fundit në qytetin e Lezhës dhe shtëpisë së subjektit dhe tokës në fshatin Ishull-Lezhë. KPK vërejti shkelje dhe dyshime për veprime fiktive lidhur me blerjen dhe shitjen e një njësie shërbimi 12 m<sup>2</sup> në qytetin e Lezhës. Nga hetimi ka rezultuar se Nikolli e ka blerë këtë pasuri në vitin 2008 për vlerën 1.2 milionë lekë dhe i'a ka shitur në shumën 3.2 milionë lekë vjehrrit të ardhshëm në vitin 2009. Nikolli është diplomuar për drejtësi në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër dhe nga viti 2001 deri në vitin 2004 ai ka mbaruar studimet në shkollën e Magjistraturës. Në vitin 2015, Nikolli ka marrë titullin "Doktor shkencash" në Universitetin European të Tiranës. Nga viti 2004 deri në vitin 2016 ka shërbyer si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nga viti 2016 si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Në vitin 2019, Nikolli u vu nën hetim për korrupsion nga ish-Prokuroria e Krimeve të Rënda, si një nga tre gjyqtarët që vendosi zbutjen e dënimit të Dritan Dajtit, i dënuar për vrasjen e 4 policëve, Dëshmorë të Atdheut më 7 gusht 2009.